

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 1387 prot.  
14

Tiranë, më 11 . 05 . 2022

**VENDIM**

Nr. 38 , datë 11.05.2022

**“PËR MIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA E SHKOLLIMIT SIPAS  
KRITERIT EKONOMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022, PËR STUDENTEN  
RONILDA TAFI, QË STUDION NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË  
PARË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, e ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1226/1 datë 09.05.2022 “Mbi miratimin e kërkesës së një studenti për përjashtim tarife sipas kriterit ekonomik për vitin akademik 2021-2022”, në mbledhjen e datës 11.05.2022,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përjashtimin nga tarifa e shkollimit sipas kriterit ekonomik, për vitin akademik 2021-2022, për studenten Ronilda Tafi, që studion në një program studimi të ciklit të parë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETAR**  
**ZAMIRA GJINI**

**ANËTARË**

**MONIKA FIDA**

**VERA OSTRENI**

**ALTINA XHAFFERI**

**ALBANA GJINOPULLI**

**ANIS THODHORJANI**

**ENDRIT YZEIRAJ**